

LIGJ
Nr.8401, datë 9.9.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7893, DATË 22.12.1994 "PËR SHKENCËN DHE ZHVILLIMIN TEKNOLOGJIK"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik" në të gjitha nenet, fjalët "Komiteti i Shkencës dhe Teknologjisë" zëvendësohen me "Ministria e Arsimit dhe e Shkencës".

Neni 2

Neni 18 i ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik" ndryshohet:

"1. Akademia e Shkencës së Shqipërisë (më tej Akademia) është institucion qendro shkencor kombëtar, që përfshin në sistemin e vet institucione shkencore, Asamblenë dhe Senatin Akademik.

2. Akademia ka për detyrë:

- të kryejë kërkime shkencore fundamentale dhe aplikative në fusha të ndryshme të shkencave sociale, humanitare, natyrore e albanologjike;

- të kujdeset për të hapur fusha të reja të kërkimeve shkencore, në përputhje me nevojat e vendit;

- t'u parashtrojë organeve shtetërore çështje të rëndësishme për gjendjen e kërkimit shkencor e të zhvillimit teknologjik në fusha të ndryshme për rrugët e zhvillimit të shkencës e të kulturës;

- të punojë për përfshirjen sa më të frytshme të shkencës shqiptare në shkencën botërore.

3. Akademia ka statutin e vet, i cili miratohet nga Presidenti i Republikës. Statuti përmban rregullat e zgjedhjes së anëtarëve të Akademisë, të organizimit, të drejtimit dhe të funksionimit të institucioneve shkencore dhe të organizmave të tjerë të saj.

Neni 3

Neni 22 i ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik", ndryshohet:

"Rregullorja

- Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore miratojnë rregulloret e organizimit dhe funksionimit të institucioneve të sistemit të tyre, në bazë të këtij ligji dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, me përjashtim të institucioneve të përcaktuara në nenin 12 pika 1, për të cilat veprohet në bazë të ligjit nr.7810, datë 6.4.1994 "Për arsimin e lartë" dhe të nenit 12 pika 2, për të cilat veprohet sipas Statutit të Akademisë së Shkencave."

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2216, datë 15.9.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep

Meidani